



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 shkronja shkronja “g” të Statutit të Komunës, në respektim të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në fuqi për mbrojtje nga COVID-19, Kryetari i Komunës me datën 10.01.2022 merr këtë:

V E N D I M

PER THEMELIMTE SHTABIT EMERGJENT PER MBROJTJE NGA COVID-19 NE KOMUNEN E VUSHTRRISE

1. Themelohet Shtabi Komunal Emergjent për koordinim të masave dhe aktiviteteve për luftim të pandemisë COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës - kryesues i shtabit
 - 1.2 **Shpëtim Zhegrova**, Nënkryetar i Komunës - anëtar
 - 1.3 **Nexhmedin Rashica**, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- anëtar
 - 1.4 **Shqiponjë Hajdari Mikushnica**, Drejtoreshë për Inspektime - anëtare
 - 1.5 **Benjamin Shala**, Drejtor për Shërbime Publike - anëtar
 - 1.6 **Miradije Maloku**, Drejtoreshë për Arsim - anëtare
 - 1.7 **Maliq Ferizi**, Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim - anëtar
 - 1.8 **Avdullah Vojvoda**, u.d. Drejtor i QKMF-së- anëtar
 - 1.9 **Shefkije Shatri**, u.d. Drejtor i Spitalit “Sheikh Zayed” – anëtar
 - 1.10 **Reshat Kovaçi**, Komandant i Stacionit Policor në Vushtrri – anëtar
 - 1.11 **Shemsi Rrahimi**, Kryetar i Bashkësisë Islame në Vushtrri – anëtar
 - 1.12 **Kumrije Zhabari**, Kryqi i Kuq dega në Vushtrri – anëtar
 - 1.13 **Arbër Hoxha**, Kryetar i Këshillit të Veprimt Rinor Lokal –anëtar
2. Detyrë e shtabit emergjent është që në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore si bartës të pozitive institucionale, të ndërmerr masa për parandalim përkatësisht mbrojtje të popullatës nga COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë. Duke ditur se në ditët e fundit është shfaqur në Kosovë varianti i ri i këtij virusi i cili sipas ekspertëve shëndetësorë përhapet shumë shpejt, është më se e domosdoshme që të përcillen në çdo kohë kërkesat dhe rekomandimet e institucioneve më të larta shëndetësore si dhe vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndërmarrje të masave të nevojshme me qëllim të tejkalimit me sa më pak pasoja të kësaj pandemie, për jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

3. Shtabi emergjent duhet të jetë në gjendje mobile 24 orë varësisht prej rrethanave dhe gjendjes së krijuar, si pasoj e virusit COVID-19.
4. Mandati i anëtarëve të shtabit emergjent do të zgjas për aq kohë sa do të jenë në fuqi masat e Qeverisë së Kosovës për luftimin e pandemisë COVID-19.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të shtabit emergjent
- Arkivit të sekretarisë



| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN | |
| 02 Nr. / Br | 46/22 |
| Nr. i fq. / Br. st | - 02 - |
| Data: / Datum | 19.01.2022 |
| VUSHTRRI - VUÇITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "P" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR KREMTIMIN E 17 SHKURTIT DITËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

1. Themelohet këshilli organizativ për kremtimin e 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë, me këtë përbërje:
 - 1.1 **znj. Medina Bunjaku** – Drejtore për Kulturë, rini dhe sport , kryesuese e këshillit organizativ;
 - 1.2 **z. Benjamin Shala** – Drejtor për Shërbime Publike, anëtar;
 - 1.3 **znj. Miradije Maloku** – Drejtore për Arsim, anëtare;
 - 1.4 **z. Nexhmedin Rashica**, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtar
 - 1.5 **z. Bujar Shatrolli** – Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar;
 - 1.6 **znj. Kadrije Meniqi** Zyrtare në DKA-, anëtare;
 - 1.7 **z. Izet Miftari** – Udhëheqës i Bibliotekës, anëtar;
 - 1.8 **z. Gëzim Saraci**, Drejtor i Qendrës Kulutrore,- anëtar;
 - 1.9 **z. Fazli Muharremi**, Anëtar;
 - 1.10 **z. Fazli Rashica**, Anëtar;
 - 1.11 **z. Shaban Krasniqi**, Anëtar;
 - 1.12 **z. Driton Verbovci**, Anëtar;
 - 1.13 **z. Urim Qirezi**, Drejtor i Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko", anëtar;
 - 1.14 **z. Enver Isufi**- Shoqatat e Dalura nga Lufta, anëtar.
2. Këshilli organizativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do ta bëjë organizimin e manifestimit për nder të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë.
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar të bëjë organizimin e manifestimit sipas protokollit zyrtar dhe të udhëheqë me manifestimin.
4. Drejtoria për Shërbime publike është e obliguar që të bëjë vendosjen e flamujve shtetrorë në qytet, pastrimin e memorialeve dhe pastrimin e gjithë qytetit.

5. Drejtoria për Arsim është e obliguar të asocojë në organizimin e manifestimit, në koordinim me DKRS – në.
6. Drejtoria e shëndetësisë është e obliguar që në bazë të vendimeve Të IKSHPK dhe Ministrisë së Shëndetësisë të jap rekomandime lidhur me mbarëvajtjen e manifestimit
7. Shefi i Kabinetit të Kryetarit përfaqëson Zyrën e Kryetarit në këshillin organizativ, dhe paraqet idetë dhe sygjerimet e Kryetarit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi
Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të këshillit organizativ
- Arkivit të Sekretarisë